

## TOPONIMIA DHE ANTROPONIMIA E HIMARËS

HELENA GRILLO

Universiteti "Isamil Qemali", Fakulteti i Mësuesisë, Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Shqipe,  
Vlorë, Shqipëri  
Email: helenagrillo@yahoo.com

### 1. Hyrje

Në studimet e sotme albanologjike ka kohë që u është kushtuar kujdes e vëmendje e veçantë të dhënave të onomastikës dhe hulumtimeve e shqyrtimeve rreth emrave të viseve (toponimeve) dhe emrave të njerëzve (antroponimeve). Shpesh të dhënat e toponimisë e antroponimisë shërbejnë si dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e veta.

Në punimin tonë do të hulumtojmë rreth toponimeve e antroponimeve të Himarës, duke shqyrtuar gjendjen e tyre të sotme, mes materialeve të mbledhura në terren, të cilat do të na ndihmojnë të nxjerrim konkluzionet përkatëse në këtë fushë duke i shqyrtuar këto të dhëna në aspektin historik e mirëfilli gjuhësor.

#### 1.1 Të dhëna të përgjithshme për krahinën e Himarës

Himara shtrihet përgjatë bregut Jonik të Shqipërisë (të cilin banorët vendas e quajnë thjesht Bregu), duke qenë në pjesën VP të tij, që nga rrëza jugore e Qafës së Llogorasë e deri në malin e Qeparosë në Juglindje, në një gjatësi në vijë të drejtë 22 km. Si kufi lindor i saj është vargmali i Çikës dhe mali i Qeparoit. Gjerësia e trevës së Himarës nga lindja në perëndim është nga 5 km në Palasë, në 8 km në fshatin Qeparo. Ajo është njëkohësisht pjesë e Rivierës Shqiptare, që fillon nga Uji i ftohtë i Vlorës dhe mbaron te Kepi i Stilit në Sarandë.

Shtirja gjeografike e trevës që ka mbuluar emërtimin Himarë ka ndryshuar historikisht. Në shek XV Himara përfshinte gjithë viset JP të Shqipërisë, trevën e sotme të Himarës, Bregun e Poshtëm (Borsh–Nivicë–Bubar), Lumin e Vlorës, Kurveleshin e Poshtëm dhe të Sipërm, trevën e Tepelenës dhe rrethet e sotme të Sarandës dhe të Delvinës, me gjithsej mbi 50 fshatra. Edhe në shekujt që vijuan Himara përfshinte trojet që shtriheshin nga Kepi i Gjuhëzës në skajin VP të Karaburunit dhe deri në Butrint në jug, në një gjatësi prej 150 km dhe gjerësi 70-80 km. Nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XX kufijtë e Himarës filluan gradualisht të tkurën, deri sa erdhën në shtirjen e sotme me 10 fshatra: Palasë, Dhërmi, Gjilekë (ish –lagje e Dhërmiut), Vuno, Lias (ish –lagje e Vunoit),

Himarë, Pilur, Kudhës, Qeparo dhe Qeparo –Fushë (ish –lagje e Qeparoit) (Kabo, 2004).

### 2. Vështrim mbi toponiminë dhe antroponiminë

*Toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe, si të tillë, kanë të përbashkët burimin e tyre kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativë). Kjo dukuri është universale për të gjitha gjuhët e botës* (Shkurtaç, 2001: 14).

Emri i Himarës del në trajtat Kemarai në shek. III p. k., Chimera te Plini në shek. I pas Krishtit, Himairai në shek. VI te Prokopi I Cezaresë, Chimara në një diplomë të vitit 1198 të perandorit të Bizantit Aleks III dhe Himara në regjistrin turk të vitit 1431. Kemarai/Himairai/Chimara/Himara. Pukëvili është i pari që është përpjekur t'i bëjë një shpjegim tjetër emrit Himarë. L. Ndrenika, me prejardhje nga Vuno, e shpjegon si "Hi me er", për shkak të shpërthimeve të mëdha vullkanike në Malet e Vetëtimitave (Ndrenika, 2004: 164). Ndonjë autor tjetër e nxjerr prejardhjen e kësaj fjale nga pellazgjishtja, d. m. th. përpara vendosjes së kontakteve me grekët; si të epokës parahomerike e sheh këtë fjalë edhe A. Baldaçi, duke u nisur nga ajo që emrat e Himarës dhe të Panormit dalin dhe në Sicili (Baldacci, 165). Ndërsa Pukëvili shkruan se Himarë do të thotë vendi i njerëzve të kuqërremtë ose të djegur nga dielli (Pouqueville, 165). Shpjegimi i tij qëndron po të kemi parasysh pozitën gjeografike të krahinës (afër detit), si dhe veprimtarinë e përditshme të banorëve (peshkatarë, blegtorë). Gjuhëtari S. Mansaku e sheh Himarë si një emër etnik; duke e shpjeguar ruajtjen e zanores a me zhvendosjen e theksit mbi të dhe të zanores së patheksuar i me atë që rënia e saj do të krijonte grupin bashkëtingëllor *hm*, i cili është i vështirë për t'u nyjtuar në gjuhën shqipe (Pouqueville, 165).

Emrin e Dhërmiut etimologjia popullore e nxjerr nga Dhrimadh, d. m. th. vendi i dhrive, ndoshta duke u mbështetur në trajtën Drimades, që del më 1581. Po arkeologu H. Ceka e lidh këtë me fjalën latine Germiniorum, që del në librin e Jul Cezarit, duke shtuar se "nuk kemi të bajmë me një vendbanim antik, por me

emnin e një fisi ose ma drejtë të një nënfisi të kaonëve, në sinurin e të cilit ndodhej Palaeste-Palasa.” (Ceka, 1965: 90 ). S. Mansaku, duke e pranuar këtë mendim, fjalën Dhërmi e nxjerr nga fjala Germinium. Sipas tij, “kalimi Germinium: Dhërmi mund të shpjgohet në shqipe me shndërrim të grykores g në ndërthëmboren dh” (Mansaku, 1982: 10).

Emri Vuno më 1581 del në trajtën Bunae, e cila shpjgohet me emrin bun, -i “vend ku kalohet nata”, prej foljes buj “kaloj natën”. E. Çabej nuk e shpjgohet këtë fjalë, po mjaftohet vetëm me pohimin se Hans Kraheja e krahason me greq. Vounos “breg, kodër”, duke e lidhur edhe me shqipen (Çabej, 1976: 371). Kalimi i b-së në v dhe theksi mbi rrokjen fundore duket se shpjgohet më mirë duke u nisur nga trajta greke.

Për emrin e Palasës, të gjithë historianët dhe gjuhëtarët që janë marrë me të, janë të një mendjeje se rrjedh nga fjala Paleste që përmend Jul Cezari. Por etimologjia e kësaj të fundit mbetet e paqartë (Ceka, 1965: 90).

Vend të rëndësishëm në toponiminë e Himarës zënë edhe toponimet kishtarë, të cilat i kanë rezistuar kohës.

### Fjalor toponimik

=A=

Adhendri - vend i zhveshur pa dru, nuk ka pyll. Gjendet në pyll

Andrehora - vendi i Andresë në Himarë. Është greqisht ky toponim η χώρα – vendi ku ka lindur. Andrehora – vendi i lindjes së Andresë

Arvat – vend në fushë

Armisdha – vend i kripur në Himarë, afër detit. Është greqisht η αρμύρα-kripësiërë

Aspropetra – gur i bardhë në Himarë, afër detit. Është toponim grek. Kompozitë e

përbërë nga dy fjalë άσπρος-bardhë (l, e) η πέτρα-guri

=B=

Barkole – vend në lëndinë. Prona të mëdha të gjelbëruara

Bebeu – një luginë që formon shira shumë të mëdha.

Vend me rrëkera të mëdha

Blerës – kullotë, afër kodrës Skutarait. Duket që është formim shqip blerës-gjelbërim, i

blertë

Bebec – vend në mal. Është shqip bebec-lloj qeni i bardhë (përdoret në Labëri)

=DH=

Dhimëkaza – vend ku vijnë shumë shira

Dhrimada – është pyll afër Skutarait (kodër)

=F=

Në studimin e toponimeve për të dëshmuar lashtësinë e hershmërinë duhet t’u japim rëndësi atyre emrave që na dëshmojnë qysh në dokumentet e vjetra të shkrimit. Dija e derisotme, me ndihmesën e mjaft studiuesve, ka bërë të shihet vijimësia iliro-shqiptare edhe nëpërmjet onomastikës (Çabej, 1979; Lafe, 1974: 137-138; Mansaku, 1982: 103-104). Ndërkaq, nuk duhet harruar që në trevat shqiptare ka edhe toponime që nuk janë përmendur në përshkrime e dokumente. R. Ushaku mendon se “kur kemi të bëjmë me mikrotoponime të shënuara më vonë, ose të vjela nga goja e popullit, mundësia e depërtimit në një burim më të hershëm kohor është e kufizuar, ndërsa mundësia e interpretimit sinkronik leksiko-semantik ka gjasa mbështetjeje në të dhëna gjeomorfologjike-topografike, ekonomiko-shoqërore dhe etnologjike të caktuara.” (Ushaku, 1987: 8).

Po listojmë një sërë toponimesh që kemi mbledhur në Himarë tek të cilat jemi mbështetur për të analizuar gjendjen e toponimisë së sotme, si dhe duke krahasuar në rrafshin diakronik me toponimet e mbledhura më parë nga vendas, të cilat na kanë rënë në dorë mes dorëshkrimeve të ndryshme.

Frengh – një luginë në të cilën gjenden shumë shpella  
=G=

Gale – anë deti

Gur – burim në Himarë. Është mes gurësh

=GJ=

Gjipe – gjiri i Porto Palermos

=J=

Jal-I – vend në Vuno, plazhi i Vunoit. Është greqisht το γυαλι-qelq. Quhet kështu se është uji i detit shumë i pastër

Jonostav – vend sipër kodrës së Skutarait

Jalovlash – mal. Ka edhe një shpellë në këtë mal si edhe një kullotë të madhe

=K=

Kallogre – vend në fushë

Kastrofiladhë – vend në mal. Është greqisht rojtar i kështjellës η σωματοφυλακμ-roje

Karidhon – vend me fruta

Kastanea – vend që ka shumë gështenja. Toponim me origjinë greke η καστανέα

Kondakivi – vend në të hyrë të Vunoit. Edhe ky toponim grek. Kompozitë e përbërë nga dy fjalë kondakivi-afër shurdhit κουτα-afër η κουφή

=L=

Ligori – vend me lagështirë

=M=

Majadhimekushte – maja e Dhimkushte (në gjinore). Është shqip

Malidhe – kullotë me shpella e shtëpi. Ka bajame, fiq.  
Në këtë kullotë nuk rritën agrume e ullinj

Mavromat – vend në mal. Nga GR Μαυρος-i zi to μάτι-syri mavromat-syri i zi

Megalihora – vend në fushë, kullotë. Μεγαλο-i madh ,  
η χώρα-vend megalihova-vendi i madh

Mjegullosh – mal mbi fshatin e Vunoit. Toponim shqip.  
Mal që rri gjithmonë në mjegull  
=N=

Ndërmaja – vend midis maleve

=P=

Pagav – është burim

Pacu – vend që dalin pllaka guri. Gurore e vendit

Prino – vend me shkure e lisa

Potam – vend në fushë ku grumbullohet uji. Vjen uji

=S=

Spartë – vend në mal ku mbledhet bagëtia

Spile – lagje në Himarë GR η σπηλιά-shpella

Skutara – kodra sipër Vunoit

Stihora – vend në Himarë. Duhet të ketë ndodhur diçka  
në këtë vend η χώρα-vend

Nga analizat gjuhësore e sasiore vërehet se kemi në një masë të konsiderueshme toponime greke. Por nuk mungojnë toponimet shqipe , aty-këtu edhe sllave e frënge. Kjo ndodh si në enklavën greqisht folëse ashtu edhe në fshatrat që flasin shqip.<sup>25</sup> Jo pa qëllim kemi mbledhur disa toponime edhe në Vuno. Aty gjejmë si toponime greke, ashtu edhe shqipe. Vetëm në Vuno ka rreth 18 toponime me emra kishtarë. Toponime kishtarë ka edhe në vende të tjera të Shqipërisë. Ato janë ruajtur që në kohën e mbretit Zog me një dekret të veçantë. Sa për toponimet me origjinë greke, pra që shpjegohen mes greqishtes, mund të themi se këto toponime janë si pasojë e përdorimit të dy gjuhëve. Duke folur greqisht njerëzit janë munduar t'i zëvendësojnë me këto fjalë greke.

### Antroponimia

Emrat e njerëzve dhe vendeve shfaqen njëherazi me lindjen e gjuhës dhe shtohen, zhvillohen e ndryshojnë ose bihen në harresë e dalin nga përdorimi sipas rrethanave historiko- shoqërore dhe kulturore që përjeton popullsia përkatëse e cdo vendi. Jo më kot thuhet se mosha e emrave të vendeve dhe të njerëzve është aq e vjetër sa edhe vetë gjuha (Daka, 1981: 105), prandaj në shekullin XX gjithandej u është kushtuar

<sup>25</sup> Në krahinën e Himarës bëjnë pjesë dy enklava gjuhësore. Enklava e Dhërmi-Palases (greqishtfolëse), enklava e Himarës (greqishtfolëse) dhe pjesa tjetër e fshatrave të Bregut si Iljasi, Vunoi, Qeparoi, Piluri, Kudhësi, që nuk kanë folur asnjëherë greqisht. Për këtë arsye shohim një mjedis gjuhësor mjaft interesant dhe studimi i kontakteve gjuhësore dhe i lënies së gjuhës (*language shift*) prej banorëve të këtyre fshatrave ka rëndësi të veçantë.

Stuvatur – mal i zhveshur në Himarë

=SH=

Shën Ajonikolla – kisha

Shën Pjetër – vend ku mbushet uji

Shën Spiridhon – vend në fushë

Shën Koll – vend në fushë, edhe kisha quhet kështu

Shën Mëri – kisha

=TH=

Thekër – vend në fushë me bace të mira, ka edhe fruta

Thodhos – vend sipër në male

=V=

Vale – lëndinë e madhe, kullotë verore. Toponim me origjinë frënge

Vendero – varreze, vend në afërsi të Himarës

Visha – qafë, kthesë në afërsi të Himarës

=Z=

Zamar – quhet një vend në Himarë. Është sllav (përtej detit)

=ZH=

Zhuplek – vend në mal afër Skutarait

rëndësi e vecantë këtyre emrave , duke i kundruar ata në shumë drejtime: në aspektin historik si dhe gjuhësor. Studimet diakronike na shërbejnë për të bërë krahasime në këtë fushë kaq interesante , si dhe për të parë perspektivën e zhvillimit të tyre.

Kontaktet historike e gjuhësore kanë bërë që në kulturën shpirtërore e gjuhësore të ndryshojnë shumë gjëra. Ndryshime të mëdha kanë ndodhur në fushën e antroponimisë.

R. Memushaj për këto ndryshime në krahinën e Himarës nënvizon: *“Kanë humbur emrat vetjakë të periudhës së lashtë dhe të mesjetës; janë shuar prej kohësh emrat e nënfiseve të Kaonisë; shumë emra gjeografikë janë zëvendësuar me fjalë të huaja, kurse një pjesë tjetër, duke kaluar në gojën e dhjetëra e dhjetëra brezave, kanë ndryshuar formën fonetike, aq sa sot është tepër e vështirë t'i dallosh në janë fjalë vandi apo të huaja.”*

Kemi listuar disa emra familjesh duke u mbështetur në të dhëna historike, si dhe nga informacioni i mbledhur nga disa informatorë të brezit të tretë. Rezulton se këto familje kanë migruar në Himarë.. Nga të dhënat rezulton se ka shumë të ardhur nga Kurveleshi, Kuçi, Zagoria. Kështu shpjegohen mbiemra të tillë himarjotësh si: Gjidede, Gjikondi, Gjikeshrati.

Ka shumë të ardhur nga Kurveleshi

Milaj – Progonat

Rexhajt

Gorajt

Gjomemo

Bollano

Marku

Llaguni

Kutulla

Kabuci

Dhimojani – Dhimua i Janit

Kallushi

Gjono

Zoto

Nga natyra e vet, antroponimet dhe toponimet dallojnë rrënjësisht prej emrave të përgjithshëm, pasi këta të fundit si pjesë e leksikut të përgjithshëm, kanë funksion përgjithsues, klasifikues, duke u përdorur për një numër të madh frymorësh ose jofrymorësh të së njëjtës klasë. Kurse emrat e përveçëm dhe emërtimet e përveçme kanë si funksion themelor thjesht shënimin, individualizimin e frymorëve dhe të objekteve, vënien e një etikete çdo njërit prej tyre, me qëllim që individ apo objekti i emërtuar të identifikohet e të dallohet me lehtësi prej individëve apo objekteve të tjera të kësaj klase (Bidollari, 2000: 148). Zakonisht emrat vetiakë janë emrat të besimit ortodoks; Irakli, Andon, Petro, Thoma, Maria Foto, Ndreko, Pavlo, Odise, Jorgo, Kiço, Marrë, Llambro, Klearko, Jani, Dhoksi, Niko, koço, Lenë, Andon, Janullë, Kleme. Kemi përndarje të formave fonetike të emrave të hershëm ndër shqiptarë: Gjon, Jani. Në brezin e mesëm e të ri ndihet një farë largimi nga këta emra, prirja e shqiptarëve për të vendosur emra të huaj. Nga ky ndikim nuk ka shpëtuar edhe krahina e Himarës, megjithëse ky ndikim ndihet më i zbutur apo errësuar. Kemi emra Daniel, Brunildë, Orsiola, Ilda, Krisida, Xheni, Stefania. Interesant është theksi tek emrat e njerëzve. Zakonisht emrat femërore marrin një ë-fundore që mban edhe theksin. *Alsidë, Kristinë, Janullë, Lenë, Klemendinë* etj.

Nga kjo pikëpamje **“shquarsia e pashquarsia formale e emrave të përveçëm”** kjo e folme afrohet me të folmen e arbëreshëve të Italisë

Nga pikëpamja strukturore patronimet mund të ndahen në dy grupe të mëdha: njëfjalëshe dhe dyfjalëshe.

Ndër prapashtesat shqipe që hasen janë: *-aj, -açi, -al (i), -an (i), ar (i), -çe, -ko, -uc (i), -ul (i), -osh (i)*.

Prapashtesa të huaja janë: *adhi, -ella, -opulli*.

Dukuri tipike për toskërishten është prapavendosja e pjesëzës pasthirmore tek emrat, që është shumë e përhapur në emrat e përveçëm: *Petro, Ndreko, Niko, Çaço*.

Kokaveshi

Kokedhima

Brigaj

Kemi emrat e tjerë:

Shkurti, Mucaj, Vogli, Kongjinaj, Bashi, Duni, Zhupa, Petromilo, Bifsha.

Rapajt janë të ardhur në Himarë.

Të ardhur nga Kuçi – Spiro, Konomaj

Të ardhur nga Zagoria – Koçaj

Të ardhur nga Mokra – Simajt

Ka edhe të ardhur nga Korça – Mitrushaj, Vasilaj, Laskaj.

Të gjitha patronimet dalin me zanore ose më-j.

Përdoren fundoret –e, -o dhe prapashtesa aj.

Ka një familje shqiptare që njihet ende sot në Greqi si shqiptare. Ata kanë emigruar: Kotroni. Kollo Kotroni është hero kombëtar i lëvizjes greke. Ka edhe një familje që njihet si greke në Himarë: Andrucu – mbiemër grek. Familje të tjera janë: Duka, Varfi, Barka, Zhebo, Zisi. Natyrisht që të flasësh për kohën e ardhjes së këtyre familjeve duhet të kesh dokumente të sakta historike, gjë e cila ne na mungon.

Mund të kenë lëvizur shqiptarë nga Himara për në vende të ndryshme. Migrimi dhe lëvizja e popullsisë është një dukuri e njohur në historinë e popujve. Shembull konkret për këtë dukuri është gjendja e një familje shqiptare në Greqi (Kotrona) si dhe gjetja e një mbiemri grek në Himarë; Andrucu.

### Bibliografia

ÇABEJ, Eqrem (1976), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, 2, Tiranë.

CEKA, Hasan (1965), *»Përputhje onomastike ilire-epirote«*, SH, 2.

DAKA, Palok (1981), *»Emrat e njerëzve në gjuhën tone«*, në “Gjuha Jonë”.

KABO, M. (2004), *»Veçori gjeografike të trevës së Himarës«*, në “Himara në shekuj” ASHSH, Tiranë

LAFE, Emil (1974), *»Toponime latine-romane në truallin e shqipes«*, në “Kuvendi I i Studimeve Ilire”, Tiranë.

MANSAKU, Seit (1982), *»Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë«*, në “Studime Filologjike”, 3, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.

USHAKU, Ruzhdi (1987), *»Ulqini dhe rrethina në dritën e disa toponimeve«*, në “Studime Filologjike”, 3, Tiranë.